



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

RAPORT I AUDITIMIT

I - DHËNIA E PËLQIMEVE PËR NDËRTIM /SHFRYTËZIM TË PRONËS SË NP KOSTT-it NGA PALËT E TJERA

II - MARRËVESHJET PËR BLERJE TË ENERGJISË SË PRODHUAR NË MES TË NP KOSTT DHE KOMPANIVE QË OPEROJNË ME BURIME TË RIPËRTËRITSHME LIDHUR ME PAGESAT/TARIFAT NXITËSE

Auditim i pajtueshmërisë

Prishtinë, Nëntor 2021

PËRMBAJTJA E RAPORTIT

Përmbledhje e përgjithshme	4
I - Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës së "NP KOSTT" sh.a nga palët e tjera.....	6
II - Marrëveshjet për blerje të energjisë së prodhuar në mes të "NP KOSTT" sh.a dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme, lidhur me pagesat/tarifat nxitëse.....	16
Shtojca I. Letër konfirmimi	19

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare. Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit, si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit “Dhënia e pëlqimeve për ndërtim/dhënia në shfrytëzim të pronës së NP KOSTT sh.a nga palët e tjera dhe Marrëveshjet e lidhura për blerje të energjisë së prodhuar në mes të NP KOSTT sh.a dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme”.

Pjesa e parë e raportit është rezultat i auditimit të kryer nga Faruk Rrahmani (udhëheqës ekipi), Bujar Bajraktari dhe Ajtene Llapashtica (anëtarë ekipi), ndërsa pjesa e dytë e raportit është rezultat i auditimit të kryer nga Florim Beqiri (udhëheqës ekipi), Sabile Muli dhe Lavdim Maxhuni (anëtarë ekipi), nën menaxhimin e Ndihmës Auditorit të Përgjithshëm, Emine Fazliu, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Përmbledhje e Përgjithshme

Ky raport është kryer bazuar në rekomandimet e Kuvendit të Kosovës të datës 12 gusht 2021 drejtuar Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA). Raporti është ndarë në dy pjesë ku pjesa e parë është përmbledhje e çështjeve nga auditimi në lidhje me 'Dhënien e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës së "NP KOSST" sh.a nga palët e tjera', përderisa pjesa e dytë është përmbledhje e auditimit të të gjitha 'Marrëveshjeve për blerje të energjisë së prodhuar në mes të "NP KOSST" sh.a dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme, lidhur me pagesat/tarifat nxitëse'.

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut sh.a (tani e tutje: KOSTT) funksionon si ndërmarrje publike në pajtim me Ligjin për ndërmarrjet publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi. Të drejtat e aksionarit për KOSTT ushtrohen nga Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Në këtë kontekst, ZKA ka kryer auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat për të cilat ne mendojmë se ishin të nevojshme për të arritur në një konkluzion rreth pajtueshmërisë dhe menaxhimit të këtij procesi.

Përmbledhje për pjesën e parë të raportit: Auditimi i vendimeve për dhënien e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronës së "NP KOSST" sh.a nga palët e tjera

Bazuar në rregullat vendore të aplikueshme, ndërtimet nën sistemin e transmisionit dhe në afërsi të caktuara janë të ndaluara pasi që KOSTT-i këto hapësira i ka të shpronësuar dhe e mban të drejtën e servitutit.

Auditimi ynë është fokusuar në vlerësimin nëse përgjigjet (pëlqimet/refuzimet) që KOSTT ju ka kthyer palëve në lidhje me ndërtimet, zhvendosjet dhe kabllimet tokësore ishin në harmoni me rregullat e brendshme, legjislacionin në fuqi dhe standardet që aplikohen për këtë qëllim. Po ashtu, kemi vlerësuar edhe procesin e dhënies së pronave me qira (dyqaneve dhe fibrave optikë).

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore janë:

E para - Menaxhimi i procesit të dhënies së përgjigjeve (pëlqimet/refuzimet) për palët ishte përcjellë me vonesa kohore në trajtimin e lëndëve, dhe mosaplikim të tarifave për institucionet publike. Po ashtu, procesi nuk kishte konsistencë sa i përket nënshkrimeve nga menaxhmenti të cilat në një periudhë ishin aplikuar kurse në një tjetër nuk ishin aplikuar.

Për adresimin e këtyre mangësive rekomandojmë që bordi nëpërmes kryeshefit të siguroj eliminimin e vonesave në trajtimin e lëndëve, aplikimin e tarifave për të gjithë dhe vendosjen e procedurave të shkruara në lidhje me aprovimet e nevojshme.

E dyta - Zona e sigurisë të transmisionit energjetik ishte cenuar nga ndërtimet e periudhave të mëhershme që ishin kryesisht ndërtime ilegale, por që ky fenomen vazhdon të ndodhë ende me një intenzitet më të ulët. Megjithatë kishte raste kur edhe përkundër definimit të kushteve teknike të përcaktuara nga KOSTT ato nuk ishin respektuar ku ndërtimet, zhvendosjet e shtyllave ishin brenda zonës së sigurisë (ku ndalohen ndërtimet).

Në disa raste KOSTT kishte informuar organet kompetente (komunat) për të ndërprerë punimet, por veprimet e ndërmarra ishin të pamjaftueshme.

Për adresimin e këtyre mangësive rekomandojmë që bordi nëpërmes kryeshefit të siguroj një bashkëpunim më efektiv me Komuna dhe palët tjera të interesit për të parandaluar plotësisht këtë dukuri.

E treta - KOSTT ka dhënë përgjigje (pëlqime/refuzime) dhe ka përcaktuar kushtet teknike për zhvendosjen e shtyllave dhe kabllimin tokësor duke u bazuar në standardet ndërkombëtare, por që nuk kishte rregullore të brendshme. Një draft rregullore është në proces por që ende nuk ishte aprovuar nga Bordi.

Për adresimin e çështjes së rregullimit të procesit të zhvendosjes së shtyllave dhe kabllimin tokësor bordi në përputhje me statutin duhet të aprovoj rregullore që definojnë në mënyrë të qartë të gjitha proceset që duhet aplikuar për këtë qëllim.

Përmbledhje për pjesën e dytë të raportit: 'Auditimi i të gjitha marrëveshjeve për blerje të energjisë së prodhuar në mes të NP KOSTT Sh.A dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme, lidhur me pagesat/tarifat nxitëse.

Auditimi është fokusuar në menaxhimin e marrëveshjeve për blerjen e energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, verifikimin nëse pagesat e bëra janë në pajtim me tarifat e përcaktuara nga Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) si dhe në procesin e inspektimit të sistemit të matjes.

Rezultati i dal nga mostrat tona të auditimit tregon se kontrollet e brendshme të vendosura nga KOSTT Sh.A. në lidhje me këtë fushë kanë funksionuar në mënyrë efektive.

Falënderojmë menaxhmentin dhe stafin mbështetës të KOSTT-it për bashkëpunimin e ofruar gjatë gjithë procesit të auditimit.

I - DHËNIA E PËLQIMEVE PËR NDËRTIM/SHFRYTËZIM TË PRONËS SË “NP KOSTT” SH.A NGA PALËT E TJERA

Hyrje

Operatori i Transmisionit, Sistemit dhe Tregut - KOSTT, operon si entitet i pavarur nga dhjetori i vitit 2005 nga transformimi i Korporatës Energjetike të Kosovës. Misioni i KOSTT-it është operimi i sigurt dhe i besueshëm i sistemit të transmetimit, duke garantuar sigurinë e furnizimit, si dhe operimin efikas të tregut të energjisë elektrike në bazën e transparencës dhe jo diskriminimit, në mbështetje të zhvillimit ekonomik dhe shoqëror të Republikës së Kosovës.

Si Operator i Sistemit të Transmetimit (OST), KOSTT-i është përgjegjës për operim efikas, ekonomik dhe të koordinuar të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Kosovë, si dhe është përgjegjës për menaxhimin e rrjedhave të energjisë në rrjetin e transmetimit që shërben për furnizimin e konsumit nacional dhe tregëtimit ndërkufitar.

Përveç përgjegjësive primare KOSTT ka edhe përgjegjësi tjera që janë të ndërlidhura me aktivitetet e saj e që një pjesë e tyre edhe ishte objektivë e këtij auditimi si:

- Ofrimi i shërbimeve profesionale për palët e treta (kyqja e burimeve të ripërtritshme të energjisë) si dhe ndërtimet e objekteve afër rrjetit të transmetimit që ndikohen me ndërtimet; dhe
- Ofrimi i shërbimeve për palët e interesuara për shfrytëzimin e kapaciteteve të lira të fibrave optik (komercializimi i fibrave optik) në infrastrukturën e telekomunikacionit.

Menaxhimi i procesit të dhënies së pëlqimeve/kushteve teknike për aplikuesit është i bazuar në UA nr. 2005/7; UA 03/2017 mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, Udhëzimin nr.278 për Dhënien e pëlqimeve për ndërtim të objekteve në afërsi të Trafostacioneve & Largpërçuesve dhe nën Largpërçues; Kodit të Pajisjeve Elektrike të KOSTT-it dhe Rregullat Teknike për Ndërtim dhe Mirëmbajtjen e Objekteve Elektroenergjetike – të trafostacioneve dhe të linjave¹.

¹ - Gazeta Zyrtare e ish-RSFJ Nr. 65/88 dhe Gazeta Zyrtare Nr.19/68.

Objektiva e Auditimit

Bazuar në kërkesën e Kuvendit të Kosovës të datës 12.08.2021 me nr.08-Re 007, takimit të zhvilluar me Komisionin për Industri, Ekonomi dhe Ndërmarrësi dhe takimeve me menaxhmentin e KOSTT-it përfshirë edhe informatave të pranuar në procesin e planifikimit, kemi përcaktuar objektivën e këtij auditimi si në vijim:

- Objektivë e parë e këtij auditimi është të vlerësojmë nëse përgjigjet të cilat kanë të bëjnë me dhënien e pëlqimeve apo refuzimin e tyre për shfrytëzim të pronave të KOSTT për palët tjera, janë në harmoni me kriteret e përcaktuara në ligjet përkatëse, standardet dhe në pajtim me statutin e ndërmarrjes, rregulloret e brendshme dhe akte tjera. Po ashtu, do të vlerësohet edhe menaxhimi i proceseve; dhe
- Objektivë e dytë e këtij auditimi është vlerësimi i dhënies së pronave (dyqaneve dhe fibrave optik) me qira.

Raporti i auditimit vlerëson pajtueshmërinë nëse dhënia e pronave (e drejta e servitudit) pëlqimet për ndërtim, për palët tjera, janë në harmoni me kriteret e përcaktuara në rregulloret e aplikueshme, ligjet respektive, apo edhe standardeve ndërkombëtare.

Fushëveprimi dhe Metodologjia i Auditimit

Ky auditim kishte në fokus vlerësimin e të gjitha përgjigjeve (pëlqime/refuzime) të cilat janë nxjerrë nga data 01 janar 2015 e deri në fund të gushtit 2021, në lidhje me dhënien e pëlqimeve për ndërtim/shfrytëzim të pronave të KOSTT-it nga palët e tjera.

Një fokus më i veçantë i është kushtuar përgjigjeve (pëlqime/refuzime) të KOSTT-it që kanë të bëjnë me caktimin e kushteve teknike për zhvendosjen e rrjetit të transmisionit apo edhe me kabllimin nëntokësor dhe realizimin e tyre.

Projektet që kanë të bëjnë me investimet kapitale të KOSTT-it, nuk kanë qenë subjekt i këtij auditimi pjesë e rekomandimit/kërkesës së Kuvendit të Kosovës për auditim, pasi që kjo pjesë do të mbulohet me një auditim të veçantë në planin vjetor të auditimit të ZKA-së për sezonin 2021/2022.

Po ashtu, dy lëndë² ishin procesuar për hetime në prokurorinë e shtetit dhe në përputhje me metodologjinë e auditimit për të mos ndikuar në hetime nuk do të jenë pjesë e raportit të auditimit.

Metodologjia e auditimit është bërë për t'iu përgjigjur objektivave specifike në lidhje me dhënien e përgjigjeve (pëlqime/refuzime) për ndërtim apo shfrytëzim të pronave të

² Rasti CC Apartments dhe rasti Ex-FIS

KOSTT-it nga palët tjera nëse ishin bërë në pajtim me kërkesat ligjore dhe me planin e ndërmarrjes.

Për të siguruar se analizat që dalin nga ky auditim janë në drejtim të arritjes së konkluzioneve adekuate audituese është konsideruar e dobishme krijimi i një dizajni dhe qasjeje të auditimit e cila do të shpie në identifikimin e mangësive të mundshme të procesit të dhënies së përgjigjeve (pëlqime/refuzime) për ndërtim, si dhe kontratave të qirasë të nënshkruara me shfrytëzuesit e pronave të KOSTT-it.

Auditimi është kryer në përputhje me SNISA 100 – Parimet themelore të auditimit në sektorin publik, SNISA 400 – Parimet themelore të auditimit të pajtueshmërisë, dhe SNISA 4000 – Standardet e auditimit të pajtueshmërisë, Kodin e Etikës së ZKA-së, si dhe kërkesat tjera relevante për auditimin e pajtueshmërisë. ZKA është e pavarur nga subjektet nën auditim. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e konkluzioneve.

Qasja jonë në këtë auditim, ishte e orientuar në marrjen e dëshmive relevante dhe të mjaftueshme për qëllime të sigurisë së auditimit dhe ishte e kombinuar duke përfshirë disa teknika audituese siç janë:

- Analizimi dhe vlerësimi i kërkesave ligjore dhe statutore për dhënien e përgjigjeve (pëlqime/refuzime) për ndërtim si dhe për dhënien e pronave të KOSTT-it në shfrytëzim/me qira;
- Intervistimi i zyrtarëve përkatës të KOSTT-it të cilët e kanë menaxhuar këtë proces (përfshirë edhe menaxhmentin) dhe diskutime eventuale sipas nevojës;
- Takimi dhe diskutimi me deputetët e Komisionit për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregëti të Kuvendit të Kosovës;
- Analizimi i procesverbaleve të takimeve të Bordit të Drejtorëve nëse është shqyrtuar dhënia në shfrytëzim e pronave për palët tjera;
- Analizimi i përgjigjeve (pëlqime/refuzime) lidhur me përcaktimin e kushteve teknike për ndërtim, zhvendosje apo kabllim nëse janë në harmoni me legjislacionin në fuqi;
- Testimin e të gjitha përgjigjeve (pëlqime/refuzime)³ për ndërtim në afërsi të transmisionit dhe shqyrtimi i kontratave të qirasë për fibra optik dhe lokaleve me qira;
- Ekzaminimi fizik i një numri të lëndëve të cilat ishin subjekt i auditimit; dhe
- Analizimi i procesit të aprovimeve/nënshkrimeve lidhur me dhënien e përgjigjeve (pëlqime/refuzime) për palët kërkuese.

³ 111 përgjigje (pëlqime/refuzime) janë audituar duke përjashtuar 2 rastet që ishin në proces të hetimeve

Gjetjet dhe rekomandimet

Gjatë auditimit, kemi vërejtur fusha për përmirësim të cilat janë paraqitur në formë të gjetjeve dhe rekomandimeve. Përmes rekomandimeve konkrete ne synojmë që menaxhimi i procesit të dhënies së përgjigjeve (pëlqime/refuzime) palëve të jetë i kornizuar me rregullativ përkatëse dhe të menaxhohen në mënyrë efikase dhe të ketë konsistencë në trajtimin e palëve.

Procesi i dhënies së pëlqimeve/refuzimeve për palët kërkuese

Nga viti 2015 e deri në gusht të vitit 2021, KOSTT-i kishte pranuar 113 kërkesa të ndryshme, të cilave KOSTT ju është përgjigjur palëve bazuar në kërkesën e tyre. Prej tyre, 96 ishin për ndërtime në afërsi të transmisionit, 10 për zhvendosje të shtyllave elektrike dhe 7 kërkesa për kabllim tokësor. Vlen të theksohet se janë realizuar vetëm 4 zhvendosje të shtyllave dhe 2 kabllime tokësor. Nga testimi i lëndëve janë identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja 1 - Vonesat në kthimin e përgjigjes për palët kërkuese

Pika 5 e nenit 10 (Procedura lidhur me paraqitjen e kërkesës për ndërtim në zonën e sigurisë) të UA 03/2017 (MZhE) mbi Rregullat e Zonës së Sigurisë, përcakton që - Ndërmarrja e energjisë duhet të japë miratimin ose refuzimin e vet për ndërtimin e paraparë, në formë të shkruar brenda afatit prej 15 ditëve pas dorëzimit të kërkesës.

Nga 111 lëndët e testuara identifikuam vonesa në 11 raste kur përgjigja e KOSTT-it ishte përtej afatit të përcaktuar. Në 9 raste vonesat sillen nga 10 deri në 25 ditë, përderisa në dy raste vonesat ishin 4 përkatësisht 7 muaj për kthimin e përgjigjes.

Shkaku i mos kthimit të përgjigjes kur vonesat ishin deri në 25 ditë ishte kryesisht mos kujdesi nga komisioni në lidhje me përmbushjen e afateve të përcaktuara, përderisa në dy rastet vonesat ishin për shkak se palët kërkuese nuk kishin kryer pagesa/tarifat.

Mospërmbushja e afateve në kthimin e përgjigjeve ndaj palëve mund të ndikojë negativisht te pala kërkuese duke i shkaktuar vonesa në procedime tjera për leje ndërtimi.

Rekomandimi 1

Bordi i drejtorëve përmes Kryeshefit duhet të siguroj se respektohet afati në të gjitha rastet për kthimin e përgjigjes prej 15 ditësh me qëllim që pala dhe komuna të jenë të informuar me kushtet teknike që duhet respektuar gjatë ndërtimit në afërsi të sistemit energjetik.

Po ashtu, duhet aplikuar procedura adekuate që e shmangin mundësinë që pala të vonojë pagesën e faturës e që kjo më pas të reflektoj në mospërmbushjen e afatit për kthimin e përgjigjes.

Çështja 2 - Mos aplikimi i tarifave financiare nga KOSTT-i

Udhëzimi nr. 278 i KOSTT-it për Dhënie e pëlqimeve për ndërtim të objekteve në afërsi të trafostacioneve & largpërquesve dhe nën largpërquesve i aprovuar nga Bordi me datë 06.05.2008 i përcakton tarifën për dhënie e përgjigjeve (pëlqime/refuzime) për palët që aplikojnë.

Kemi identifikuar 14 raste kur palëve ju ishte kthyer përgjigja (pëlqimi/refuzimi) nga KOSTT-i përkundër faktit që nuk ishte kryer pagesa. Vlera financiare që nuk ishte paguar për këtë qëllim sipas tarifave ishte në shumë prej 3,000€. Prej tyre, 10 raste ishin për institucione publike (Komuna, Ministri dhe Ndërmarrje Publike) në vlerë prej 2,580€, kurse në katër (4) raste për persona fizik⁴ në vlerë prej 420€. Po ashtu, në katër (4) raste tjera faturimi nuk ishte në përputhje me tarifën në udhëzues qoftë si rezultat i aplikimit të TVSh-së apo edhe aplikimit të kilometrave jo saktë.

Sipas zyrtarëve të KOSTT-it që e kanë menaxhuar këtë fushë kjo kishte ndodhur për shkak që për institucionet publike e kanë vlerësuar si të panevojshme aplikimin e tarifave (edhe pse sipas udhëzimit nuk kishte përjashtime për institucionet publike), përderisa te personat fizik nuk kanë dhënë ndonjë sqarim.

Mos aplikimi i tarifave për të gjitha palët kërkuese nga ana e KOSTT-it ndikon në trajtimin jo të barabartë të palëve dhe ka ndikim edhe në aspektin financiar.

Rekomandimi 2

Bordi i drejtorëve përmes Kryeshefit duhet të siguroj se tarifën aplikohen për të gjitha palët kërkuese të cilët pranojnë një përgjigje nga KOSTT pa e favorizuar asnjë palë, në të kundërtën të plotësohet/ndryshohet udhëzimi dhe të specifikohet se në cilat raste dhe kush lirohet nga tarifa/pagesa. Po ashtu, te faturimi duhet të rritet kujdesi që çmimet të jenë në harmoni të plotë me udhëzimin.

⁴ Njëri nga personat fizik nuk kishte kryer pagesën me arsyetim se është e veterane e luftës.

Çështja 3 – Mangësitë në menaxhimin e procesit të dhënies së përgjigjeve (pëlqime / refuzime) nga KOSTT

Menaxhimi i procesit të dhënies së përgjigjeve (pëlqime/refuzime), kushteve teknike për aplikuesit është i bazuar në UA nr. 2005/7; UA 03/2017⁵ mbi Rregullat për Zonat e Sigurisë, Udhëzimin 278; Kodit të Pajisjeve Elektrike të KOSTT-it dhe Rregullat Teknike për Ndërtim dhe Mirëmbajtjen e Objekteve Elektroenergjetike - të trafostacioneve dhe të linjave. Ne identifikuam se:

- Në 65 raste (2015-2018) përgjigja që i është kthyer palës kërkuuese përveç nënshkrimeve të komisionit ishte përcjellë me shkresën përcjellëse të nënshkruar nga kryeshefi ekzekutiv kurse në 44 tjera (2018-2021) përgjigjet nuk ishin nënshkruar nga kryeshefi.

Përderisa në dy raste kërkesat nuk ishin shqyrtuar nga Departamenti për Menaxhim & Inxhinieri të Projekteve, siç kërkohet në udhëzimin nr. 278 të KOSTT-it. Kërkesat kishin të bënin me vendosjen dhe zhvendosjen e shtyllave elektrike, përgjegjen e të cilave e kishte dhënë kryeshefi dhe jo departamenti/komisioni; dhe

- Në të gjitha përgjigjet që ju kanë dhënë palëve në shkresën e KOSTT-it nuk ishte e specifikuar se në cilin nen të udhëzimit apo rregullave teknike janë thirrur për vendosjen e kriterëve, por vetëm është theksuar si shënim në fund të përgjigjes se për më tepër shih UA 03/2017 përkatës dhe rregullat teknike mbi ndërtimin.

KOSTT nuk kishte procedura qartë të shkruara në asnjërin prej rregullativës së lartëcekur se cili model i aprovimeve/nënshkrimeve duhet ndjekur në mënyrë që të ketë kontrolle adekuate dhe trajtim të njëjtë.

Rekomandimi 3

Bordi i drejtorëve duhet të siguroj procedura të qarta lidhur me aprovimet/nënshkrimet, njëherit duhet të sigurojë se të gjitha kërkesat për përgjigje (pëlqime/refuzime) duhet kaluar për shqyrtim nga departamenti profesional përkatës sipas udhëzimit në fuqi.

⁵ UA nr. 2005/7 ka mbuluar fushëveprimin e auditimit 01.01.2015 deri në mars 2017, kurse nga kjo periudhë deri në gusht 2021 është mbuluar me UA 03/2017

Çështja 4 - Ndërtimet brenda zonës së sigurisë së transmisionit

Pika 4 e nenit 27 të Ligjit për Energjinë Nr. 05/L-081 parasheh që - Të gjitha linjat dhe tubat e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë që kalojnë përmes, mbi, apo nën një pronë konsiderohet se e kanë të drejtën e servitutit të përhershëm mbi pronën e prekur në favor të ndërmarrjes së energjisë.

Pika 2 e nenit 31, parasheh që - Brenda çfarëdo zone të sigurisë është i ndaluar ose i kufizuar ndërtimi ose ngritja e çfarëdo ndërtese, prerja e bimëve ose pemëve, ose ushtrimi i aktiviteteve që mund të paraqesin rrezik ndaj sigurisë ose veprimtarisë së pandërprerë të instalimeve energjetike, sigurisë së shëndetit, jetës dhe pronës.

Gjatë ekzaminimit fizik kemi identifikuar raste ku ishte cenuar zona e sigurisë, si rezultat i mos respektimit të kritereve sipas pëlqimeve/kushteve teknike dhe ndërtimeve të paautorizuara si në vijim:

- Ndërtimi i Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë – Prishtinë, ishte afër linjës së transmisionit rreth 5m përderisa KOSTT-i i kishte lëshuar pëlqim sipas kushteve teknike që distanca të jetë minimum 7m. Kjo distancë nuk ishte respektuar gjatë ndërtimit, përkundër që mbikqyrja e zbatimit të kritereve është kompetencë e komunës, megjithatë zona e sigurisë ishte e cenuar;
- Komuna e Prizrenit kishte bërë zhvendosjen e shtyllës së linjës ekzistuese 110kV afër rrugës (projekti transiti i vjetër) rreth 2m, përderisa KOSTT-i i kishte lëshuar pëlqim me kushtet teknike/projekt që distanca deri te skaji i rrugës të jetë 40m, në rastet kur nuk lejohet kushtet jo më e vogël se 10m. Raporti i komisionit për pranim teknik i datës 22.01.2016 konfirmon se nuk janë kryer punët/zhvendosja e shtyllës sipas kushteve teknike. KOSTT përmes email-it kishte njoftuar komunën për korrigjimin e mangësive të identifikuara, megjithatë në terren gjendja mbetet e njëjtë; dhe
- Një rast i ndërtimit nën linjën e transmisionit⁶ 110kV i cili nuk kishte marrë pëlqim/kushte teknike për ndërtim⁷, ishte identifikuar nga departamenti i mirëmbajtjes i cili në bazë të rregullores së mirëmbajtjes bën kontrollimin e trasesë në aspektin e cenimit të zonës nën linjë njëherë në gjashtë muaj. KOSTT kishte njoftuar organet kompetente dhe punimet ishin ndërprerë.

⁶ Rasti Ndërmarrja e re Amortizatorët

⁷ Pas ndërprerjes së punimeve pala kishte bërë kërkesë për kushte teknike dhe KOSTT i kishte dhënë përgjigje duke ja përcaktuar kushtet teknike

Në teren kemi vërejtur edhe objekte tjera (shtëpi, lokale etj.) të ndërtuara kryesisht viteve të mëhershme të cilat ishin nën linjën e transmisionit në kundërshtim me ligjin. Duhet theksuar se departamenti i mirëmbajtjes kishte filluar informimin e dy komunave për objektet të cilat e cenonin zonën e sigurisë dhe disa rasteve individuale, por që bashkëpunimi në mes KOSTT dhe akterëve relevant/palëve të interesit kërkon shumë progres për të arritur efektet e duhura.

Cënimet e zonës së sigurisë janë bërë kryesisht si shkak i mos paisjes me kohë me pëlqime/kushte teknike, apo edhe mos zbatimit të standardeve dhe rregullave teknike të parapara me kushte teknike të përcaktuara nga KOSTT. Duhet theksuar se KOSTT nuk e praktikon monitorimin nëse po zbatohen kushtet teknike, me rastin e ndërtimeve, pasi kjo është kompetencë e komunave.

Ndërtimet brenda zonës së sigurisë ndikojnë direkt në cenimin e zonës së sigurisë të transmisionit të linjave, duke shkaktuar vështërsi në qasje të linjave (kufizim mbi të drejtën e servitutit), dhe rrezikimin e jetës dhe shëndetit të qytetarëve.

Rekomandimi 4

Bordi i drejtorëve përmes Kryeshefit duhet të siguroj një bashkëpunim efektiv me të gjitha komunat dhe palët tjera të interesit përmes komunikimit të vazhdueshëm për të parandaluar cenimin e zonës së sigurisë të transmisionit në tërë vendin. Po ashtu, KOSTT duhet të monitoroj më shpesh linjat dhe ndërtimet që kryhen në afërsi të sistemit të transmisionit për të shmangur rrezikimin e servitutit mbi pronat e veta.

Çështja 5 - Aplikimi i rregullave teknike për zhvendosje të linjave dhe kabllimit tokësor

Statuti i KOSTT-it⁸ i në nenin 7 thekson se aksionari ose bordi i drejtorëve duhet të nxjerrë rregullore për administrimin dhe funksionimin e KOSTT-it, e të cilat rregullore mund edhe të ndryshohen ose revokohen.

KOSTT për çështjen e zhvendosjes së linjave dhe kabllimit tokësor deri më tani ka aplikuar standardin IEC 60840 dhe EN 50341-1 dhe të njëjtat standarde janë aplikuar si për investimet vetanake të KOSTT-it ashtu edhe të investitorëve privat.

Në anën tjetër për dhënien e pëlqimeve/kushteve teknike për ndërtimet në afërsi të transmisionit ishte aplikuar rregullorja mbi normat teknike për ndërtimin e linjave të energjisë me voltazhe minimale nga 1kV deri në 400 kV⁹ (Kjo rregullore ishte anuluar me vendimin e Qeverisë së Kosovës nr. 15/36 të datës 22.09.2021.

KOSTT nuk ka rregullore të brendshme që e rregullojnë zhvendosjen e linjave, kabllimit tokësor dhe ndërtimeve në afërsi të transmisionit. Duhet theksuar se në vitin 2020 KOSTT ka filluar hartimin e rregullorës¹⁰ së brendshme dhe me 12.07.2021 i është dërguar bordit për aprovim por ende kjo rregullore nuk ishte e aprovuar nga ana e Bordit.

Shfrytëzimi i standardeve dhe rregulloreve me të cilat ka operuar KOSTT mund të kenë qenë jo mjaftueshëm të aplikueshme për nevojat e KOSTT-it. Poashtu, anulimi i rregulloreve paraprake nga Qeveria pamundëson KOSTT-in që të shqyrtoj kërkesat që mund të vijnë tani e tutje nga palët e ndryshme si rezultat i mungesës së bazës ligjore.

Rekomandimi 5

Bordi i drejtorëve duhet të aprovoj rregullore të brendshme që janë në harmoni me legjislacionin përkatës dhe standardet si dhe definojnë në mënyrë specifike procedurat dhe kriteret lidhur me zhvendosjet e linjave, kabllimet tokësore dhe ndërtimet në afërsi të zonave të sigurisë. Po ashtu, edhe aspektet administrative duhet definuar përmes procedurave të shkruara për të eliminuar çdo paqartësi në procesin e trajtimit dhe zbatimit të tyre.

⁸ Statuti i fundit nr.1888 i datës 23.11.2020

⁹ Gazeta Zyrtare e ish-RSFJ Nr. 65/88 dhe Gazeta Zyrtare Nr.19/68.

¹⁰ Rregullorja për definimin e kriterëve teknike për segmentimin e linjave ajrore të tensionit të lartë 110kV me kablllo nëntokësore

Qiratë e dyqaneve dhe fibrave optike

KOSTT, aktualisht ka pesë dyqane të dhëna me qira dhe tri kontrata të qirasë për fibra optikë. Sipas informatave dhe të dhënave të ofruara nga KOSTT, dyqanet e dhëna me qira, prej vitit 1999 kanë qenë të uzurpuara dhe pas shumë përpjekjeve të menaxhmentit të KOSTT-it kanë arritur që ti vendosin nën kontroll, përmes negociatave me uzurpuesit (edhe pse kjo çështje ishte në kontest gjyqësor por për gjithë këto vite nuk kishte marrë ndonjë epilog).

Në vitin 2016, kryeshefi ekzekutiv ka formuar një komision për identifikimin e dyqaneve (pronave) që i takojnë si asete KOSTT-it. Komisioni ka identifikuar dhe i ka propozuar menaxhmentit se dyqanet e uzurpuara të lëshohen me qira (duke lidhur kontrata me shfrytëzuesit aktual). Çmimet janë përcaktuar duke marrë parasysh çmimet e qirasë të cilat i zbaton edhe Ndërmarrja Publike Banesore, në lokalitetin ku ndodhen edhe objektet KOSTT-it. Kontratat janë ripërtirë kryesisht çdo 1 vit dhe aktualisht ato janë ende valide.

Përderisa për një dyqan që ishte nënmenaxhim të KOSTT-it në vitin 2015 ishte zhvilluar një procedure në formë të ankandit për qira dhënie ku ishte përzgjedhur oferta me çmimin më të lartë.

Qiratë për fibra optik

Rregullorja për shfrytëzimin e përbashkët të infrastrukturës alternative (passive/Fiber optike) e aprovuar nga Bordi me 19.04.2017 i lejon KOSTT-it që të ofrojë shfrytëzim të përbashkët të infrastrukturës duke dhënë me qira tepricën e kapaciteteve të fibrave optike.

Nga kjo periudhe dhe aktualisht KOSTT ka marrëveshje për dhënien në shfrytëzim të rrjetit të fibrave optik me tre operator. Çmimet e këtyre kontratave janë të bazuara në tarifën e përcaktuara me këtë rregullore. Nga auditimi nuk kemi vërejtur se ka devijime nga tarifën e përcaktuara me rregulloren e brendshme.

Nuk kemi rekomandime nga kjo fushë.

II - MARRËVESHJET PËR BLERJE TË ENERGJISË SË PRODHUAR NË MES TË NP KOSTT SH.A DHE KOMPANIVE QË OPEROJNË ME BURIME TË RIPËRTËRITSHME, LIDHUR ME PAGESAT/TARIFAT NXITËSE

Hyrje

Aktiviteti kryesor i KOSTT-it është menaxhimi dhe operimi i sistemit të transmisionit dhe energjisë së Kosovës, si dhe është përgjegjës për transmisionin e energjisë tek rrjetet elektrike të tensionit të lartë. Si operator tregu, KOSTT-i është përgjegjës për organizimin dhe administrimin e tregtisë së energjisë dhe gjithashtu menaxhon procesin e marrëveshjeve të shit-bletjeve të energjisë elektrike në Kosovë.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE), me datë 27 prill 2017 kishte miratuar Rregullën nr.10-2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, me të cilën e obligon KOSTT-in që të nënshkruaj marrëveshjet me gjeneratorët e energjisë së ripërtëritshme.

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregulle, brenda gjashtëdhjetë (60) ditëve aplikuesit të cilët posedojnë vendim për autorizim preliminar¹¹ apo vendim për autorizim final¹² të cilat janë lëshuar sipas Rregullës për Procedurën e Autorizimit para hyrjes në fuqi të kësaj rregulle, duhet të bëjnë kërkesë me shkrim te Operatori i Tregut (OT) për të lidhur marrëveshje për blerje të energjisë. Marrëveshjet ekzistuese për blerje të Energjisë të lidhura në mes të furnizuesit Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike (KESCO Sh.A.) dhe Gjeneratorëve për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë (BRE), barten nga KESCO Sh.A. në OT (KOSTT Sh.A.), më së largu deri më 31 dhjetor 2017.

KOSTT (OT-në) dhe gjeneratorët ekzistues të BRE-ve (të bartur nga KESCO), do të lidhin marrëveshje për blerje të energjisë të aprovuar sipas kësaj Rregulle, e cila marrëveshje do të jetë e vlefshme vetëm për periudhën e mbetur të saj. Numri i marrëveshjeve që kanë kaluar nga KESCO Sh.A. në KOSTT Sh.A. ishte tetë (8).

KOSTT bazuar në vendimin final të ZRRE-së përgatit draft marrëveshjen të cilën e përcjell tek bordi i ZRRE-së për miratim se, gjeneratori përkatës i plotëson kriteret për nënshkrim të marrëveshjes bazuar në nenin 17 të rregullës nr. 10-2017. Pas miratimit nga ZRRE nënshkruhet marrëveshja në mes të KOSTT dhe gjeneratorit.

Me vendim nr.V-810-2016 të dt.19.05.2016, ZRRE ka filluar të aplikojë tarifa nxitëse për

¹¹ ZRRE do t'i lëshoj aplikuesit vendim për Autorizim Preliminar nëse është vërtetuar se aplikuesi ka dëshmuar përshtatshmërinë e tij për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese, por se nuk ka plotësuar ende kërkesat si: Marrëveshja për kycje në rrjet, Leja për ndërtim dhe Pëlqim Ujor apo Leje ujore në rast të hidrocentraleve. Këto dëshmi duhet të sillen me rastin e parashtrimit të kërkesës për shndërrimin e Vendimit për Autorizim preliminar në Autorizim Final

¹² Vendim i lëshuar nga Bordi i ZRRE, duke treguar përmbushjen me sukses të kërkesave nga aplikuesit dhe jepet autorizimi final për fillimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese.

gjeneratorët e BRE-ve, si dhe përshtatjen vjetore të inflacionit pas vitit të parë të operimit.

Nga viti 2017 deri në gusht të vitit 2021, KOSTT menaxhon 32 marrëveshje, prej tyre në operim komercial janë 25 gjenerator përderisa shtatë (7) janë në proces të finalizimit të ndërtimit të kapaciteteve gjeneruese.

Marrëveshjet për blerjen e energjisë (hidroenergja dhe biomasa solide) kanë kohëzgjatje prej 10 vitesh, ndërsa marrëveshjet për blerjen e energjisë elektrike të gjeneruar nga panelet fotovoltaike dhe gjeneratorët e erës kanë kohëzgjatjen 12 vjeçare.

Operatori i Sistemit (departament në kuadër të KOSTT-it), sipas kodit të matjes, është përgjegjës për inspektim dhe testimin e të gjitha Sistemeve Matëse kur të instalohen nga gjeneratorët dhe periodikisht pas instalimit.

Për çdo muaj OT pranon raportet e matjeve dhe faturën nga gjeneratorët, i kontrollon ato dhe pas verifikimit të raportit të matjeve dhe faturës bëhet pagesa për MW-ët e prodhuar në pajtim me vendimin për tarifën nxitëse të përcaktuar nga ZRRE përfshirë edhe përshtatjen e inflacionit.

Objektivi dhe fushëveprimi i auditimit

Objektivë e këtij auditimi ishte verifikimi nëse menaxhimi i marrëveshjeve të lidhura mes KOSTT Sh.A. dhe prodhuesve me burimet e ripërtitshme të energjisë (BRE), si dhe pagesat që ndërlidhen me këto marrëveshje ishin në pajtim me legjislacionin përkatës. Fushëveprimi i auditimit ishin të gjitha marrëveshjet për blerjen e energjisë së prodhuar në mes të NP KOSTT Sh.A. dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtitshme lidhur me pagesat/tarifën nxitëse.

Auditimi ka përfshi ekzaminimin e dokumenteve që ndërlidhen me marrëveshjet për blerjen e energjisë, pastaj vlerësimin e tyre dhe pagesat, si në vijim:

- nëse para nënshkrimit të marrëveshjes për blerjen e energjisë nga burimet e ripërtitshme ekziston vendimi përfundimtar i aprovuar nga ZRRE;
- nëse kohëzgjatja e marrëveshjes e lidhur mes palëve është sipas kërkesave të rregullës nr.10-2017 për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtitshme të Energjisë;
- nëse pagesat e bëra për tarifën nxitëse janë sipas vendimit të caktuar nga ZRRE, si dhe përshtatja e inflacionit është bërë në pajtim me vendimet vjetore të nxjerra nga ZRRE; dhe
- nëse pagesat e bëra ishin dokumentuar me dëshmi përkatëse sipas raportit të gjeneruar nga sistemi i matjes.

Konkluzion

KOSTT ka nënshkruar 32 marrëveshje¹³ me gjeneratorët e BRE-ve nga të cilat është planifikuar që të prodhohen 169.20 MWH. Nga viti 2017 deri në gusht 2021, KOSTT ka kryer pagesa në vlerë prej 65,115,100€ për blerjen e energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme solare, era, biomasa dhe hidrocentralet (gjeneratorët e BRE-ve).

Kemi testuar të gjitha marrëveshjet si dhe 77 pagesa në vlerë prej 12,915,764€ (për 146,546 MWH energji të prodhuar). Prej pagesave të testuara 8 ishin për energji të prodhuar nga era, 27 solare si dhe 42 pagesa për energji të prodhuar nga hidrocentralet. Po ashtu, kemi ekzaminuar sistemin e matjeve në teren si dhe raportet tremujore të inspektimeve të kryera nga Operatori i Sistemit për të gjitha marrëveshjet.

Nga auditimi i marrëveshjeve dhe pagesave, konstatojmë se:

- Para nënshkrimit të marrëveshjeve ka ekzistuar vendimi përfundimtar i aprovuar nga ZRRE;
- Kohëzgjatja e marrëveshjeve mes palëve ishte sipas kërkesave të rregullës nr.10-2017 për Skemën mbështetëse për gjeneratorët e burimeve të ripërtëritshme të energjisë;
- Pagesat ishin bërë bazuar në tarifatat nxitëse duke u bërë edhe përshtatja e inflacionit bazuar në vendimet e ZRRE-së; dhe
- Pagesat ishin të dokumentuara me dëshmitë përkatëse sipas raportit të gjeneruar nga sistemi i matjes.

¹³ 21 marrëveshje të lidhura me gjeneratorët që shfrytëzojnë ujin, 4 marrëveshje të lidhura me gjeneratorët që shfrytëzojnë erën, 6 marrëveshje të lidhura me gjeneratorët që shfrytëzojnë energjinë solare dhe 1 me biomasë

Shtojca I. Letër konfirmimi

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C
OPERATOR SISTEMA PRENOËA I TRŽIŠTA KOSTT d.d

Nr. 2470 Dt. 18 11 2021
PRISHTINË-A

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU S.M.A.
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA, PRENOËA I TRŽIŠTA A.D.



LETËR E KONFIRMIMIT

18 nëntor 2021

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për Draft raportin e Auditimit “ Dhënia e pëlqimeve për ndërtim /shfrytëzim të pronës së KOSTT-it nga palët e tjera” dhe “Marrëveshjet për blerje të energjisë së prodhuar në mes të NP KOSTT dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme lidhur me pagesat/tarifat nxitëse” dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e “ Dhënies së pëlqimeve për ndërtim /shfrytëzim të pronës së KOSTT-it nga palët e tjera” dhe “Marrëveshjet për blerje të energjisë së prodhuar në mes të NP KOSTT dhe kompanive që operojnë me burime të ripërtëritshme lidhur me pagesat/tarifat nxitëse”(në tekstin e mëtejshëm “Raporti);
- pajtohem me gjetjet dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për zbatimin e tyre.

Z. Jeton Mehmeti
Kryesuesi i Bordit të Drejtorëve në KOSTT

